



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.256/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA, me seli në Mitrovicë, dhe Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Mitrovicë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3,350.00 (*tremijë e treqind e pesëdhjetë*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 07.06.2017, përmes dërgesës postare, ndërsa sipas datës 12.06.2017 e protokolluar me nr.256/2017, me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017, posteri i kandidatit Agim Bahtiri për deputet nga radhët e koalicionit LDK-AKR-ALTRNATIVA është mbuluar në mënyrë të kundërligjshme, pra në të njëjtin vend është vendosur posteri i kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës Xhavit Haliti nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës ligjore i Nenit 33 paragrafi 1 pika b e LZP-së. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur tri fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, kërkesa me numër 05/13 i datës 07.06.2017 nga drejtoria e Inspeksionit në Mitrovicë .

Koalicioni LDK-AKR-ALTERNATIVA dega në Mitrovicë, me nr. 244 të datës 13.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës Anr.256/2017, të parashtuar kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Mitrovicë.

PZAP-i, pas shqyrtimit ankesës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, vlerëson se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, rezulton se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në objekte publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), i LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e vlerësuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA, është shkelur neni 33, pika b), i LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti në fjalë, janë vendosur në objekte publike .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase Koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga koalicioni në fjalë, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në objekte publike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni LDK-AKR-ALTRNATIVA, me nr. 244/2017 të datës 13.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.256/2017 i datës 12.06.2017, e parashtruar ndaj Koalicionit PDK-AAK-NISMA, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në mbështetje të nenit 54 par.1 i Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që “*Tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim*”. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i Koalicionit PDK-AAK-NISMA, ka cenuar interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të

dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) i LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 256/2017 i datës 13.06.2017



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.